



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

STRATEGJIA E EC MA NDRYSHE 2015 – 2019

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)
Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V), 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

Përmbajtja

1.	HYRJE	3
2.	VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	4
3.	QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	6
3.1.	QËLLIMI STRATEGJIK 1.....	6
3.1.1.	Objektiva Strategjike 1.1.....	6
3.1.2.	Objektiva Strategjike 1.2.....	7
3.2.	Qëllimi Strategjik 2.....	8
3.2.1.	Objektiva Strategjike 2.1.....	8
3.2.2.	Objektiva Strategjike 2.2.....	9
3.2.3.	Objektiva Strategjike 2.3.....	9
3.2.4.	Objektiva Strategjike 2.4.....	9
3.3.	Qëllimi Strategjik 3.....	10
3.3.1.	Objektiva Strategjike 3.1.....	10
3.3.2.	Objektiva Strategjike 3.2.....	10
3.3.3.	Objektiva Strategjike 3.3.....	10
4.	ANEKS.....	11
4.1.	Programet e organizatës dhe iniciativat kryesore	11
4.2.	Struktura organizative dhe përgjegjësitë kryesore.....	11
4.3.	Menaxhimi financiar	12
4.4.	Partneritetet strategjike	13
4.5.	SWOT.....	14

1. HYRJE

Strategji në mënyrën e EC-it

Gjatë planifikimit strategjik, është vërejtur se më e rëndësishme për EC është qasja e saj e përgjithshme sesa temat me të cilat merret. Për këtë arsye, EC shihet më shumë se sa vetëm një organizatë e cila merret me trashëgiminë kulturore, planifikimin urban apo qeverisjen e mirë. Procesi i planifikimit strategjik ishte në thelb një ushtrim për të nxjerrë në pah identitetin e organizatës dhe e vendosjen e kornizave të veprimit bazuar në këtë identitet. Gjatë gjithë këtij ushtrimi, në të cilin morën pjesë një numër i konsiderueshëm personash, u analizuan të gjitha aspektet e veprimit të organizatës. Momenti në të cilin po hartohet ky dokument strategjik përfaqëson një orientim të ri të punës së EC-it, fillim i një periudhe të re në veprimtarinë e organizatës e cila synon të shndërrohet në shembullin më të mirë të organizimit komunitar në Prizren dhe Kosovë.

Një numër i proceseve të rëndësishme ligjore, institucionale dhe politika kanë nisur në qeverisjen lokale në Kosovë. Në mesin e tyre, ndër më të rëndësishmet janë reforma e qeverisjes lokale, rishikimi i dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit lokal, bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal si dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje. Të gjitha këto procese e gjejnë EC-in me një qasje të re strategjike që synon t'i mobilizojë dhe orientojë resurset ekzistuese dhe të ardhshme për të lehtësuar komunikimin mes komunitetit dhe qeverisë lokale në Prizren. Sipas orientimit të ri strategjik, EC do të ketë orientim të tërësishëm komunitar, e cila do ta vendosë në pozitën e ndërmetësit për të siguruar pjesëmarrje të njëmendtë qytetarë në vendimmarrje. Ky dokument i rivedinon misionin, vizionin dhe vlerat e EC-it, duke reflektuar në punën e viteve të fundit dhe orientimet strategjike për vitet në vijim. Misioni i organizatës do të jetë: EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Ndërsa vlerat të cilat e udhëheqin punën e organizatës janë: paanshmëria, aktivizmi, orientimi drejt rezultateve dhe komuniteti bazë e veprimmit.

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

Qëllimi Strategjik 1 – Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët

Objektiva Strategjike 1.1 – Rritje të pranisë së EC-it në komunitet ashtu që të avancojmë njohuritë tona, të promovojmë aktivizmin dhe mobilizimin qytetar

Objektiva Strategjike 1.2 – Thellim i angazhimit, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Qëllimi Strategjik 2 - Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve

Objektiva Strategjike 2.1 – Ndërveprim me institucionet ashtu që të siguroj marrëdhënie të shëndosh në mes të qytetarëve dhe institucioneve.

Objektiva Strategjike 2.2 – Rritje e njohurive për temat që EC trajton për të tejkaluar sfidën e mungesës së materialeve/literaturës në këto fusha

Objektiva Strategjike 2.3. – Ngritje e kompetencës dhe kapaciteteve profesionale.

Objektiva Strategjike 2.4 – Rritje e ndikimit përmes komunikimit efikas me grupe të ndryshme/komunitet për të transmetuar mesazhin. (PR)

Qëllimi Strategjik 3 – Përbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike

Objektiva Strategjike 3.1 – Optimizimi i resurseve, strukturës organizative dhe shtrirjes së përgjegjësive brenda organizatës.

Objektiva Strategjike 3.2 – Avancim i programeve dhe angazhimit, siguroj menaxhim efikas të organizatës dhe programeve, duke përbushur me sukses misionin e organizatës.

Objektiva Strategjike 3.3 – Menaxhim financiar, kapacitete për ngritje të fondeve dhe sigurim i qëndrueshmërisë.

2. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Kohëve të fundit, në Prizren është duke u rritur aktivizmi qytetar, ku rasti më i fundit është ai i kundërshtimit të rrëzimit të Kino Lumbardhit, për shkak se kjo është kinemaja më e vjetër e qytetit. EC ka luajtur rol tepër të rëndësishëm në ngritje të zërit për çështje të rëndësishme në Prizren, mobilizim të qytetarëve dhe mobilizim të akterëve të ndryshëm të shoqërisë për të qenë pjesëmarrës aktiv në formësimin e ambientit jetësor në Prizren. EC nw vazhdimësi promovon trashëgiminë kulturore duke formësuar tutje identitetin e Prizrenit, luan rol kyç në përmirësim të transparencës së organeve komunale, dhe nxitë mobilizimin e qytetarëve, shoqërisë civile, medieve dhe akterëve tjerë për të kërkuar llogaridhënie nga organet komunale.

Avokimi i vazhdueshëm i EC-it për mbrojtje dhe promovim të Qendrës Historike në Prizren ka mundësuar kështu edhe tërheqjen e vëmendjes së donatorëve për restaurim të kësaj qendre dhe monumenteve tjera kulturore në Prizren, ndalim dhe rrënim të ndërtimeve të egra dhe ilegale në parkun e Prevallës duke ia kthyer natyrën qytetarit, dhe formim të Forumit Transparenca që paraqet sinergji të kapacitetit intelektual të gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile për të monitoruar dhe mbajtur llogaridhënës organet komunale.

Zhvillimet e viteve të fundit në Kosovë, me theks të veçantë zgjidhja e disa çështjeve tejet fundamentale të nivelit nacional sikurse shpallja e pavarësisë dhe përfundimi i pavarësisë së mbikëqyrur, kanë sjellë momentum të ri ku tek qytetarët është duke u thyer miti se me politikë dhe çështje të funksionimit të shtetit dhe rregullimit të jetës shoqërore merren politikanët e nivelit të lartë dhe ndërkombëtarët. Rrjedhimisht, EC në përputhje me mandatin e saj dhe rrethanat e krijuara si rezultat i angazhimit tonë dhe zhvillimeve tjera, ka vendosur rrugën dhe qëllimin e saj si më poshtë.

Vizioni

Qytete funksionale që qeverisen nga të gjithë.

Misioni

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Vlerat

1. *Paanshmëri* – EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion.

2. *Aktivizmi* – Anëtarët e EC do të jenë aktivist të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës.
3. *Orientuar drejt rezultateve* – Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura.
4. *Komuniteti bazë e veprimit* – EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht.

3.1. QËLLIMI STRATEGJIK 1

Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët

EC është shndërruar në një nga organizatat më kredibile dhe më të besueshme nga qytetarët në Prizren. EC shihet si një nga organizatat e cila ka arritur të ngjallë kritikën e qytetarëve në Prizren, të mobilizoj qytetarët, gazetarët dhe akterët tjerë, dhe të ketë ndikim në zhvillimet e ndryshme në të gjitha nivelet. EC ka arritur të ketë ndikim edhe në proceset për të cilat është menduar se qytetarët nuk mund t'i shtyjnë përpara interesat publike, përfshirë këtu trashëgiminë kulturore apo transparencën komunale.

EC do të vazhdojë edhe më tutje të angazhohet në bashkëpunimin me qytetarët dhe të rris bashkëveprimin e qytetarëve ndërmjet vete, me organet shtetërore, sektorin publik dhe privat. EC synon që ndikimi i qytetarëve të rritet edhe më shumë përmes zhvillimit të modeleve të suksesshme të mobilizimit të qytetarëve. EC do të angazhohet që komuniteti të jetë mirë i organizuar dhe të jetë kyç në formësimin e ambientit ku jeton. Të gjitha angazhimet e EC do të jenë të dobishme për zhvillimin e demokracisë në vend, shfrytëzimin optimal të potencialit intelektual, fizik dhe financiar të qytetarëve dhe të resurseve të vendit për të pasuruar ambientin jetësor, pasurimin e jetës kulturore dhe të bashkëveprimit dhe ko-ekzistimit të kulturave të ndryshme, si dhe të mirat e tjera që vijnë nga komuniteti mirë i mobilizuar.

EC do të shtrihet dhe thellon angazhimin e saj përtej Prizrenit, fillimisht me fokus në Prishtinë dhe gradualisht edhe në qendrat tjera. Ne tanimë jemi duke u angazhuar në projekte që kanë të bëjnë me shumë me ndërtimet ilegale dhe Qendrën Historike në Prishtinë. Këto projekte kanë ndihmuar që të përfshijmë qytetarë të Prishtinës si anëtarë të EC, përmes hulumtimit të kuptojmë më mirë kontekstin dhe të përgatisim terrenin për të thelluar angazhimin në Prishtinë.

Përmes projekteve të ndryshme, EC ka arritur që me sukses të identifikoj të gjitha çështjet të cilat do të ndikojnë në rritje të nivelit të mobilizimit të qytetarëve. Duke pasur parasysh se ky është qëllimi mw i madh i Strategjisë, angazhimi kryesor i EC-it do të jetë në këtë drejtim, ku përfshihen edhe aktivitete mjaftë sfiduese sikurse që është aktivizimi i qytetarëve në bazë të lagjeve.

3.1.1. Objektiva Strategjike 1.1.

Rritje të pranisë së EC-it në komunitet ashtu që të avancojmë njohuritë tona, të promovojmë aktivizmin dhe mobilizimin qytetar

EC deri më tani ka zhvilluar aktivitete mjaftë të suksesshme dhe ka arritur që në nivel lokal të ketë mjaftë ndikim dhe të gëzojë përkrahje nga qytetarët dhe grupet e ndryshme. Përkrahja nga qytetarët ka rezultuar me një EC shumë më të fuqishëm ku të gjeturat dhe rekomandimet e EC përveç që kanë qenë të argumentuara ato kanë pasur legjitimitet në shkallë të lartë, duke e bërë EC-in të konsiderohet si organizatë me nivel të lartë të ndikimit.

EC do të thellojë edhe më shumë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me qytetarët përmes fokusimit më të madh në iniciativat në komunitet, strukturimit të vullnetarizmit, aftësimin të qytetarëve për t'u vetë-organizuar, krijimit të grupeve nëpër lagje dhe kështu me radhë.

EC do të filloj me zhvillimin e modelit të **Lagjes gjithëpërfshirëse**. Një projekt i tillë do të synoj që angazhimi i EC-it të koncentrohet nëpër lagje, ku do të zhvillohen takime me përfaqësues të lagjeve, do të diskutohen çështje të ndryshme me grupe të caktuara dhe do të synohet të përcaktohen veprimet të cilat do të kontribuonin në përmirësimin e mëturjes të ambientit jetësor nëpër lagje. Në fokus të këtij angazhimi do të jetë nxitja e aktivizmit dhe bashkëveprimit qytetar për të përmirësuar dhe pasuruar ambientin e tyre jetësor, si dhe për të shtyrë edhe organet shtetërore, sektorin publik dhe sektorin privat që të mbështetë iniciativat e tyre. Lagjja gjithëpërfshirëse do të zhvillohet përmes takimeve me përfaqësuesit e lagjeve, ngritjes së kapaciteteve të banorëve për të bërë planifikim të projekteve, përpilim të projekt propozimeve, ngritje të fondeve, avokim më efikas, si dhe bashkëveprim me banorët për të zhvilluar performanca dhe aktivitete që e pasurojnë jetën komunale të tyre.

EC do të krijoj **Miqte e EC-it**, i cili synon të jetë një format i organizimit të personave të cilët dëshirojnë të jenë pjesë aktiv në angazhimet e EC-it. Kjo formë e organizimit do të mundëson që EC të jetë sa më afër qytetarëve, qytetarët të njohin EC-in nga afër, dhe të ketë potencial për mobilizim të qytetarëve kurdo që paraqitet nevoja.

3.1.2. Objektiva Strategjike 1.2.

Thellim i angazhimit, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Angazhimi i EC-it në Prizren ka evoluar dhe gjatë tërë kohës kemi arritur që të bëjmë përparim në angazhimin tonë si dhe shtim të intensitetit të aktiviteteve. EC ka zgjedhur që angazhimin e saj ta shtrijë në shtresa të ndryshme, ku qëllimi përfundimtar është që EC të jetë i pranishëm me aktivitete dhe komunikim në njësi sa më të vogla të organizimit të komunitetit. Sipas kësaj Strategjie, EC do të fokusoj angazhimin e saj nëpër lagje duke synuar që qytetarët në lagje të jenë mirë të organizuar për të vepruar dhe ndikuar në formësimin e ambientit të tyre jetësorë.

Mundësitë për zgjerim gjeografik të EC-it në qendra tjera përtej Prizrenit dhe Prishtinës janë shumë të mëdha për shkak të mungesës të organizatave të njëjta sikurse EC dhe për shkak të reputacionit të mirë. Shtrirja e EC është më e komplikuar për shkak se është më shumë se një proces teknik ku shtrirja duhet të bëhet ngadalë dhe e shoqëruar me qasjen, vlerat, dhe filozofinë e njëjtë të veprimit sikurse në Prizren ku edhe ka filluar punën EC-i. Në këtë mënyrë është duke shkuar zgjerimi në Prishtinë, ku pas fazës fillestare të hulumtimeve mbi ndërtimet ilegale dhe Qendrën Historike, EC-i në Prishtinë do të filloj me aktivitetet të ngjashme me ato të cilat deri tani i ka zhvilluar në Prizren, përfshirë këtu takimet për qytetin gjithëpërfshirës dhe mobilizimin e grupeve të ndryshme për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore. Në Prishtinë përveç komunikimit me institucionet komunale të cilin tashmë e ka qe një kohë, EC do të filloj komunikimin me shtresat e ndryshme të shoqërisë dhe më vonë do të zbris në lagje për të organizuar komunitetin në lagje.

EC në vazhdimësi do të ketë angazhime të vogla jashtë Prizrenit dhe Prishtinës, të cilat do të kenë për qëllim vendosjen e kontakteve me grupet e ndryshme në këto vende dhe njoftimin e qytetarëve dhe organeve komunale me veprimtarinë e EC. Deri në fund të kësaj Strategjie, angazhimi i EC-it në këto vende nuk do të jetë shumë i thelluar por vetëm sipërfaqësor krahasuar me angazhimin e EC në Prizren dhe Prishtinë.

3.2. QËLLIMI STRATEGJIK 2

Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

EC-i është tejet e interesuar që cikli i veprimit të saj në terren të përmbillet me politika të cilat reflektojnë mbi rekomandimet të cilat nxirren nga EC dhe institucione të përgjegjshme që zbatojnë në mënyrë efikase politikatat. EC ka rezultate mjaftë të mira deri më tani në kritikë publike ndaj veprimeve të dëmshme të organeve shtetërore, ofrimin e alternativave për të adresuar çështjet problematike si dhe inicimin e një agjende të caktuar. Të gjitha këto kanë qenë tejet domethënëse në krijimin e identitetit dhe ngritjen e imazhit të EC-it. Rrjedhimisht, EC-i vetëm sa do e forcojë edhe më tutje kritikën dhe do zhvilloj mekanizma për të komunikuar sa më mirë mesazhin.

Një nga problemet më të mëdha është zbatimi i ligjit, ku zyrtarët e organeve shtetërore abuzojnë me pushtetin dhe tejkalojnë kompetencat e tyre duke dëmtuar kështu interesin publik qoftë përmes nxjerrjes së akteve ligjore apo shkeljeve ligjore në dëm të qytetarëve. Pandëshkueshmëria ka luajtur rol shumë të madh në krijimin e një ambienti të tillë, tejet të korruptuar. EC përmes angazhimit në identifikimin e mangësive në ligje dhe shkeljeve ligjore të organeve shtetërore ka siguruar që këto dukuri të dokumentohen dhe të ketë presion publik për këto çështje. Për më tepër, përmes hulumtimeve dhe analizave ka arritur që problemet e qytetit të Prizrenit t'i ngritë në nivele të ndryshme, duke arritur kështu që ato probleme të përfshihen edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.

EC-i përmes angazhimit aktiv për të kritikuar veprimet e dëmshme të organeve komunale dhe atyre qendrore ka arritur që të vë në pah shumë dëme që janë bërë dhe të sfidoj në forma të ndryshme organet shtetërore. Duke parë efikasitetin e kësaj forme të veprimit, EC do të investoj edhe më shumë në ngritje të kapaciteteve hulumtuese për t'u bërë një "do-tank" i fuqishëm, ku pas hulumtimeve dhe analizave do të ketë veprim aktiv për të arritur zbatimin e rekomandimeve.

3.2.1. Objektiva Strategjike 2.1.

Ndërveprim me institucionet ashtu që të siguroj marrëdhënie të shëndosh në mes të qytetarëve dhe institucioneve.

Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe ende ka sfida tepër të mëdha me fusha të ndryshme të qeverisjes në vend. Partitë politike janë grupe të organizuara kryesisht me interesa ekonomike personale të cilat vazhdojnë të kenë kontroll me mbikëqyrje tepër të dobët mbi shumë aspekte të jetës shoqërore dhe institucionale. Kur ekziston ky standard i ultë i kulturës institucionale, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm vetëm sa e lejon hapësirën e veprimeve që rezultojnë në dëm të qytetarëve.

EC-i do të angazhohet të jetë kritikues aktiv i proceseve të ndryshme duke forcuar edhe më tutje mbikëqyrjen e veprimeve të organeve shtetërore. Për më tepër, EC do të shtyjë përpara edhe procese tjera. Monitorimi i qeverisjes lokale dhe i institucioneve të tjera relevante për jetën e qytetarëve të Prizrenit do të jenë në qendër të punës së EC-it si organizatë watchdog. Monitorimi do të shikojë edhe institucionet qendrore të qeverisjes, në të gjitha rastet që lidhen me ambientin jetësor në Prizren.

Një nga angazhimet e rëndësishme të organizatës do të jetë lehtësimi i komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve. EC-i do t'i shfrytëzojë të gjitha lidhjet me grupet e komunitetit, si dhe komunikimet e reja për të nxitur veprimin qytetar përmes ofrimit të mjeteve dhe platformave adekuata të aktivizimit. Paralelisht me nxitjen e qytetarisë aktive, organizata do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet

relevante (përfshi nivelin qendror) për hartimin dhe zbatimin e politikave publike, duke u siguruar që ato politika (vendime, dokumente, akte, etj.) po i marrin parasysh nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe që qytetarët janë pjesë aktive e proceseve vendimmarrëse.

3.2.2. Objektiva Strategjike 2.2

Rritje e njohurive për temat që EC trajton për të tejkaluar sfidën e mungesës së materialeve / literaturës në këto fusha

EC-i është i përkushtuar për ndërtimin e një sistemi të brendshëm të prodhimit të dijes, i cili do t'i ushqejë programet, projektet, veprimet dhe planifikimet e ardhshme strategjike të organizatës. Në terma konkretë, duke filluar na viti 2015 organizata do të anagzohet për ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi të hulumtimeve, e cila do të ketë statusin e njësisë së veçantë programore brenda strukturës organizative. Ndërtimi i kësaj njësie nënkupton konsolidimin e kapaciteteve hulumtuese dhe të sistemit të menaxhimit të informacionit, si dhe standardizimin e publikimeve të organizatës. Prodhimi i dijes do të jetë njëri ndër orientimet më të rëndësishme të EC-it në vitet e ardhshme.

Në ndërtimin dhe konsolidimin e kapaciteteve hulumtuese, organizata do të fokusohet në resurset ekzistuese si dhe to të vlerësojë nevojat për ekspertizë të jashtme. Programe të ndërtimit të kapaciteteve për stafin ekzistues dhe angazhime të përkohshme dhe të përhershme të ekspertizës shtesë do të përbëjnë veprimet strategjike për ngritjen e kësaj njësie programore të organizatës, duke filluar nga viti 2015. EC nuk synon të shndërrohet në një organizatë të pastër hulumtuese (think-tank), por mungesa e literaturës (dijes) në fushat ku organizata punon, ka prodhuar si nevojë ndërtimin e një kapaciteti të brendshëm hulumtues në shërbim të programeve të tjera të organizatës.

3.2.3. Objektiva Strategjike 2.3.

Ngritje e kompetencës dhe kapaciteteve profesionale.

Gjatë viteve të fundit të veprimit, EC është profilizuar në disa fusha të ngushta profesionale, përfshi trashëgiminë kulturore dhe planifikimin urban. Gjatë viteve të ardhshme, organizata do të angazhohet për ngritjen e kompetencës dhe kapaciteteve të brendshme profesionale, përmes programeve të aftësimi për stafin ekzistues, si dhe angazhimit të ekspertizës së jashtme për periudha të shkurtra dhe afatgjatë. Ngritje e kompetencës profesionale do të jetë një nga përkushtimet themelore të organizatës në rrugën për t'u shndërruar në organizatën lidere të fushave të ngushta profesionale.

3.2.4. Objektiva Strategjike 2.4.

Rritje e ndikimit përmes komunikimit efikas me grupe të ndryshme/komunitet për të transmetuar mesazhin.

Për shkak të orientimit strategjik të deklaruar në këtë dokument për të forcuar komunikimin e grupet e komunitetit në Prizren, EC-i do të investojë në konsolidimin e një sistemi të komunikimit efikas me publikun. Të gjitha prodhimet e organizatës dhe veprimet që targetojnë grupe të komunitetit do të strukturohen përmes këtij sistemi të komunikimit. Për të siguruar qasje strategjike ndaj komunikimit me publikun, organizata do të hartojë dokumentin strategjik të komunikimit, përmes të cilit do të parashihen veprimet konkrete të komunikimit të punës dhe zhvillimit të legjitimitetit të organizatës karshi grupeve të komunitetit, sektorit të shoqërisë civile, medias, autoriteteve publike dhe palëve të tjera relevante.

3.3. QËLLIMI STRATEGJIK 3

Përbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

Menaxhimi efikas i resurseve njerëzore dhe teknologjike të EC-it do të realizohet përmes procesit të optimizimit të resurseve, që do të ndikojë në strukturën organizative dhe shtrirjen e përgjegjësive brenda organizatës. Ndër orientimet themelore të këtij qëllimi strategjik do të jenë avancim i programeve dhe angazhimit, sigurimi i menaxhimit efikas të organizatës dhe programeve, duke përbushur me sukses misionin e organizatës dhe menaxhim financiar që do të sjellë kapacitete për ngritje të fondeve dhe do të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të organizatës.

3.3.1. Objektiva Strategjike 3.1.

Optimizimi i resurseve, strukturës organizative dhe shtrirjes së përgjegjësive brenda organizatës.

Optimizimi i resurseve ekzistuese të organizatës do të jetë hapi i parë e menaxhimit më efikas të resurseve njerëzore dhe teknologjike. Në këtë drejtim, organizata do të detajojë termet e referencës për të gjithë stafin, duke e rimenduar ndarjen e brendshme të përgjegjësive dhe alokimin më adekuat të kapaciteteve. Një nga angazhimet e rëndësishme do të jetë shtrirja e mendimit strategjik dhe kontributit të stafin në realizimin më efikas të misionit të organizatës. Zbatimi i këtyre reformave të brendshme do të jetë një proces i përhershëm brenda organizatës, që kërkon reflektim të vazhdueshëm dhe rimendim të alokimit të resurseve në realizimin e detyrave.

3.3.2. Objektiva Strategjike 3.2.

Avancim i programeve dhe angazhimit, sigurimi i menaxhimit efikas të organizatës dhe programeve, duke përbushur me sukses misionin e organizatës.

Qëllimet do të jenë kryefjala e veprimit të organizatës. Të gjitha projektet, iniciativat dhe veprimet e tjera të EC-it do të dizajnohen dhe zbatohet duke i marrë për bazë qëllimet për të cilat angazhohet organizata. Rrjedhimisht edhe rishikimi i veprimeve gjatë kohës së zbatimit të aktiviteteve do të realizohet për të respektuar dhe për t'u siguruar që ato po kontribuojnë në përbushjen e qëllimeve të organizatës. Kjo kërkon përditësim të rregullt të strategjisë së organizatës dhe proces të përhershëm të dokumentimit të punës, ndikimit, rezultateve dhe përbushjes së objektivave strategjike të përcaktuara me këtë dokument.

3.3.3. Objektiva Strategjike 3.3.

Menaxhim financiar, kapacitete për ngritje të fondeve dhe sigurim i qëndrueshmërisë.

Pjesë e procesit të optimizimit të resurseve do të jetë edhe komponenta e menaxhimit financiar të organizatës. Përmes vlerësimit dhe rishikimit të resurseve në këtë komponentë, do të synohet menaxhim më efikas financiar dhe rritja e kapaciteteve për ndritje të fondeve që do të përkthehet në qëndrueshmëri më të gjatë institucionale dhe financiare të organizatës. Një nga risitë në veprimet e EC-it do të jetë hartimi i paketës së shërbimeve, që do të ndihmojë organizatën në diversifikimin e të hyrave. Gjithashtu, një nga orientimet strategjike më themelore të organizatës viteve në vijim do të jetë rritja e ndikimit në programimin e fondeve të donatorëve. Në veçanti, EC-i synon që të shndërrohet në një organizatë e cila ngrit fonde në mënyrë pro-aktive, duke e zvogëluar përqindjen e fondeve të siguara reaktivisht (duke iu përgjigjur thirrjeve të donatorëve).


4. ANEKS

4.1. PROGRAMET E ORGANIZATËS DHE INICIATIVAT KRYESORE

Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC Ma Ndryshe do të funksionojë me këto tri programe:

1. Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)
Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane).
2. Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)
Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit dhe rolin watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.
3. Hulumtim (prodhim i dijes)
Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

4.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE



Organizimi i EC në të ardhmen do të bëhet në bazë të programeve: Qyteti Gjithëpërfshirës, Qeverisja e Mirë, dhe Hulumtimi. Gjatë hulumtimit dhe punëtorisë së stafit të EC për planifikim strategjik është theksuar nevoja që udhëheqësit e programeve të EC të kenë rol të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë, rishikimin e saj, si dhe në menaxhimin e projekteve. Për më tepër, EC është shoqatë dhe punon me komunitetin, gjë që e bën mjaftë të përshtatshëm termin **Kryesues ose Udhëheqës** për udhëheqësit e programeve. Ky term përmban edhe një element shumë të rëndësishëm, që i bie se Kryesues/Udhëheqës i Programit zgjedhet një nga kolegët për një mandat prej dy viteve me mundësi të ri-zgjedhjes të pakufizuar. Kryesues/Udhëheqës do të thotë se përveç udhëheqjes së Programit, Kryesuesi/Udhëheqësi do të jetë në vazhdimësi i përfshirë edhe në zbatimin e projekteve. Ky do të jetë edhe një motiv për kolegët të cilët mund të kenë njohuri më të mëdha që të marrin pozitën e Kryesuesit/Udhëheqësit pa ndonjë problem të madh apo procedurë. Po ashtu, ndërrimi i pozitës nga Kryesues/Udhëheqës në ndonjë pozitë tjetër brenda organizatës nuk nënkupton vlerësim negativ por vetëm një lëvizje përbrenda organizatës. Pranimi i rolit të Kryesuesit/Udhëheqësit të Programit do të thotë që kolegu do të marrë përgjegjësi më të mëdha por prapë do të jetë në shumë aspekte si pjesëtarë i ekipit. Kryesues njëherit nënkupton se personi në këtë pozitë duhet të jetë edhe anëtarë i Kuvendit të EC Ma Ndryshe.

E njëjta nevojë është paraqitur edhe për çështjen e financave, ku tanimë organizata ka nevojë që të ketë plane strategjike për qëndrueshmëri financiare dhe menaxhim më të avancuar. Për këtë qëllim, EC duhet të ketë **Drejtor** të Administratës dhe Financave. Vetë termi Drejtor nënkupton se për këtë pozitë do të vlerësohet profesionalizmi dhe nuk do të jetë pozitë me mandat të kufizuar sikurse për Kryesues/Udhëheqës të programeve.

Niveli i tretë do të përbëhet nga zbatuesit e projekteve, të cilët njëkohësisht mund të jenë duke punuar në programe të ndryshme. P.sh., EC ka nevojë për një person që do të angazhohet minimalisht në pozitën e Zyrtar-it për administratë dhe financa, për të evituar konfliktin e interesit në raste sikurse ai i "petty cash"-it. Rrjedhimisht, një person që punon në ndonjërin program do të detyrohet të ndaj 20% të kohës për të kryer edhe detyrat e parapara për këtë pozitë.

4.3. MENAXHIMI FINANCIAR

Duhet të përfshihen disa forma të gjenerimit të një fondi për raste emergjente apo përkrahje të aktiviteteve të cilat nuk përkrahen nga projektet e donatorëve. Këto forma përfshijnë:

20% konsulencë – Stafi i EC do të angazhohet 80% në projekte për të cilat paguhen, ndërsa 20% do të angazhohen në konsulencë të organizatës, të cilat do të shërbejnë për të krijuar qëndrueshmëri të organizatës.

Linja Overhead – EC do të përfshijë një linjë të veçantë të quajtur Overhead në planifikimet buxhetore të projekt propozimeve të saj. Kjo linjë do të jetë nga 5-10% e buxhetit të përgjithshëm. Një pjesë e konsiderueshme e donatorëve janë të hapur për këtë qasje pasi që e kuptojnë se është e pamundur që të gjitha kostot e projektit të jenë kosto të drejtpërdrejta dhe se organizata duhet të kryej investime dhe shpenzime të cilat në mënyrë të tërthortë ndërlidhen me projektin.

Miqtë e EC – EC duhet të krijojë program për miqtë e saj, ashtu që organizata të jetë në gjendje që të Linja e buxhetit e cila do të krijohet nga projektet e tilla do të shërbejë për investime kapitale, shpenzime operative dhe paga për organizatën, kur këto nuk

4.4. PARTNERITETET STRATEGJIKE

EC duhet të mirëmbajë pozicionin e saj të fuqishëm në Forumin Transparenca dhe të njëjtin ta themeloj në Prishtinë. Rrjeti i Organizatave të Kulturës është platforma tjetër ku organizata duhet të thellojë angazhimin e vet. Anëtarësia e organizatës në të gjitha rrjetet tjera (Forumi Kulturor, Civikos, SEE Heritage) duhet të konsolidohet dhe EC-i duhet të shtojë përpjekjet për arritjen e qëllimeve të veta edhe duke mobilizuar veprime në kuadër të këtyre rrjeteve.

Anëtarët e EC, çdo dy javë duhet të shpenzojnë një ditë të tërë duke u takuar me anëtarë të komunitetit. Atë ditë do të lihen anash të gjitha angazhimet e tjera të organizatës dhe do të jetë një ditë kushtuar komunitetit. Edhe pse takimet do të shihen si takime joformale prapë se prapë ato duhet të jenë të strukturuar.

4.5. SWOT

FAKTORË QË KONTROLLOHEN NGA BRENDA

PIKAT E FORTA	PESHA
Organizim dhe seriozitet në punë/Stafi i motivuar për punë - Etika e punës	3
Liria e shprehjes, mundësia për t'i shpalos vlerat e stafit	3
Afërsia me komunitet	3
Harmonia në staf, kolegjaliteti	3-
Konsistenca në veprim	2.5
Trashëgimia kulturore dhe urbanizmi	2.5
Niveli i lartë i aktivizmit te stafi	2-
Kreativiteti	
Diversiteti i profesioneve	


PIKAT E DOBËTA	PESHA
Mungesa e qasjes sistematike për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme dhe në bazë të profilit	3
Mungesa ose pamjaftueshmëria e mendimit kritik brenda stafit	3
Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për ngritje të fondeve	3
Kompetenca e pamjaftueshme profesionale dhe në shkrim	3
Mungesa e aftësive për prezantim dhe përfaqësim cilësor të organizatës	3-
Rehatia e stafit në marrjen e përgjegjësive / zona e komfortit / mungesa e iniciativës	2.5
Përshtatja e gjuhës ndaj audiencave të ndryshme	2
Ndarja në dy zyre që shkakton probleme në komunikim të shpejtë brenda stafit (përfshirë administratë dhe financa)	1.5
Mungesa e sesioneve orientuese për stafin e ri	
Fokusimi i duhur i energjisë në kritikë dhe ofrim të zgjidhjeve	
Mungesa e intervenimit direkt	
Databazë me të dhëna të ndryshme që grumbullohen nga organizata	

FAKTORË TË JASHTËM


MUNDËSITË	PESHA
Kredibiliteti/besueshmëria në EC nga qytetarët/opinioni publik	3+
Numri i vogël i OJQ-ve që trajtojnë tema të njëjta/ngjashme	3
Mungesa e dijes sistematike në temat e EC-it dhe materiali i bollshëm për hulumtime	3
Orientimi i fondeve të donatorëve ndërkombëtarë në nivelin lokal	3
Imazhi i mirë i EC-it tek donatorët	3
Shfrytëzimi i potencialit që ekziston në rrjetet ku veç është EC	2.5
Mungesa e organizimit të komunitetit (përfshirë rininë)	2
Nevoja për EC edhe në qytete tjera	2
Eksplorimi i praktikave të mira në Kosovë dhe rajon që mund të shfrytëzohen nga EC	2
Potenciali në rritje për punë vullnetare (kryesisht të rinjtë)	2
Trendi pozitiv i zhvillimit turistik të rajonit të Prizrenit (mundësia për shërbime)	2
Gatishmëria e disa institucioneve për të bashkëpunuar me EC-in (Komuna e Prishtinës)	2
Shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme për nevoja të EC-it (jashtë hulumtimeve)	1.5
Trendi në rritje i vetëdijes për ruajtje të trashëgimisë kulturore	1.5
Trendi në rritje i afërsisë së qytetarëve ndaj EC-it	1.5
Shfrytëzimi për nevoja të organizatës i rrjetit të kontakteve personale	1.5
Shfrytëzimi i medieve dhe raporteve të mira me media	

RREZIQET	PESHA
Interesimi i ulët i komunitetit / lodhja e komunitetit nga aktivitetet e EC-it	3
Mungesa e besimit të komunitetit në ndryshim, lodhja nga tryezat	3
Mungesa e burimeve alternative të financimit	2.8
Mbrojtja e vlerave kulturore / kultura nuk është prioritet i institucioneve / politikave publike	2.5
Qeverisja e keqe në komunën e Prizrenit	2.5
Lodhja nga EC e mediave lokale Prizren	2
Qasja e mbyllur e institucioneve dhe mungesa e kulturës së komunikimit	2
Mosinteresimi i donatorëve për trashëgimi kulturore	1.5
Perceptimi i jashtëm ku EC barazohet me opozitë	1.5
Lodhja e institucioneve nga EC	1.5
Tendencat për rekrutim nga partitë politike	1
Duplikim i aktiviteteve me organizatat tjera	1

Strategjia e EC Ma Ndryshe 2015-2019 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 24 Janar 2015, në Prizren



Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Kreshnik Basha, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve



Në emër të stafit të organizatës
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv